

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6954
E enjte, 27 korrik 2023
Çmimi 0.40

Pesë vjet pa Adem Demaçin

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI MBAN KONFERENCË PËR MEDIE, FLET PËR SITUATËN NË VERI

KURTI: NUK MUND TË KETË ZGJEDHJE PARA SE TË SHTENSIONOHET SITUATA NË VERI

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ka bërë me dije se zgjedhjet në katër komunitat në veri nuk mund të zhvillohen pa u shtensionuar situata në atë zonë. Por, ai ka thënë se Kosova është duke i kryer përgatitjet për zgjedhje të parakohshme në këto katër komuna. "Nuk besoj se dikush pret që pa u bërë deeskalimi i plotë të ketë zgjedhje në veri", ka thënë Kurti



REAGIM I KMDLNJ-së




16 MILIONË PËR ÇLIRIMTARËT QENKAN SHUMË, QINDRA MILIONË EURO PËR RRYMËN NË VERI NUK PËRMENDEN. ÇFARË POSHTËRSIE! I FAQE 7

"ENVER ZYMBERI DO TË MBETET SIMBOL I PËRJETSHËM I SOVRANITETIT DHE I LIGJSHMËRISË NË KOSOVË" I FAQE 7



AKTUALE



CHOLLET NOMINOHET PËR POZITËN E NËNSEKRETARIT TË MBROJTJES NË SHBA F. 2

30 HEKTARË NË SUHAREKË I KALOJNË NË PRONËSI MINISTRISË SË MBROJTJES F. 6

QEVERIA EMËRON BORDIN E RI TË FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE F. 7

EKONOMI



ATK-ja NIS ZBATIMIN E PROJEKTIT "PERSONAT E PASUR" F. 8

DHOMA E TREGTISË KËRKON TË PËRMIRËSOHEN KUSHTET NË VENDIN E PUNËS F. 8

SPORT



KOSOVA LUFTON DERI NË FUND NDAJ DANIMARKËS, POR NUK MJAFTON F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Chollet nominohet për pozitën e nënsekretarit të Mbrojtjes në ShBA

WASHINGTON, 26 KORRIK - Këshilltari i lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, është nominuar për pozitën e nënsekretarit të Mbrojtjes për Politikë në ShBA.

Chollet, i cili ka qenë i përfshirë në disa çështje të Ballkanit Perëndimor si në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, u urua për këtë nominim nga sekretari amerikan i shtetit, Antony Blinken. "Urime shokut tim për nominimin e tij për të shërbyer si nënsekretar i Departamentit të Mbrojtjes për Politikë. Me konfirmonim e tij humbja jonë do të jetë fitorja e Departamentit të



Mbrojtjes dhe vendi ynë do të vazhdojë të përfitojë nga shërbimi i tij i përkushtuar", ka shkruar

Blinken në "Twitter". Chollet u shpreh falënderues ndaj Blinkenit dhe ndaj mundësisë

"për t'u kthyer në Departamentin e Mbrojtjes dhe të punoj me sekretarin e Mbrojtjes për sigurinë e kombit tonë".

Chollet, nominimin e të cilit duhet ta konfirmojë edhe Senati amerikan, ka qenë i përfshirë në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë për normalizim të marrëdhënieve. Në janar ai kishte qëndruar në Prishtinë dhe Beograd si pjesë e një turneu rajonal.

Në një intervistë të dhënë për Radion Evropa e Lirë gjatë kësaj vizite, ai kishte thënë se marrëveshja finale në mes të Kosovës dhe Serbisë do të kërkonte "zgjedhje të vështira"

dhe "kurajë politike". "Të dyja qeveritë duhet të jenë në gjendje të tregojnë gatishmëri për kompromis. Ne mendojmë se këto kompromise janë të mundshme. Ne po përpiqemi të gjejmë zgjidhje kreative, për t'i ndihmuar ata që t'i bëjnë ato kompromise", kishte thënë Chollet.

Postin për të cilin është dominuar Chollet e kishte mbajtur Colin Kahl që nga prilli i vitit 2021. Ai e kishte konfirmuar largimin e tij në maj të këtij viti, pasi kishte drejtuar përgjigjen e administratës së presidentit Joe Biden ndaj pushtimit të Ukrainës nga Rusia.

Digjet një anije mallrash pranë Holandës, vdes një person

AMSTERDAM, 26 KORRIK - Një pjesëtar i ekuipazhit të një anije mallrash vdiq të mërkurën në afërsi të Holandës pasi anija që po transportonte gati 3 000 vetura u kaplue nga zjarri.

Roja bregdetare holandeze tha se anija po vazhdonte të digjej dhe se edhe disa persona të tjerë kishin mbetur të lënduar. Tentimet për ta shpëtuar anijen po vazhdojnë ende pranë Holandës, në një vend të rëndësishëm për shpendët shtegtarë. Varka dhe helikopterë u përdorën për t'i ndihmuar 23 anëtarët e ekuipazhit pasi ata u përpoqën ta shuajnë zjarrin, tha roja bregdetare në një

deklaratë.

Disa nga anëtarët e ekuipazhit u hodhën nga kuverta e anijes në det dhe u kapën nga një varkë shpëtimi, tha kapiteni i varkës së shpëtimit për transmetuesin holandez NOS. Disa pjesëtarë të ekuipazhit pësuan kocka të thyera, djegie dhe probleme në frymëmarrje dhe u dërguan në një spital në Holandën veriore, thanë shërbimet e urgjencës. "Aktualisht ka shumë anije në vendngjarje për ta monitoruar situatën dhe për ta parë se si të vihet nën kontroll zjarri", tha në telefon zëdhënësja e rojës bregdetare, Lea Versteeg. "Por, gjithçka varet nga moti dhe



dëmtimi i anijes".

I pyetur nëse ishte e mundur që anija të fundosej, Versteeg tha se ky "është një skenar që po e marrim parasysh dhe po përgatitemi për të gjithë

skenarët".

Roja Bregdetare dha një përditësim pak para mesditës, duke thënë se situata nuk ka ndryshuar.

Anija Fremantle po lundronte

nga porti gjerman i Bremerhavenit për në portin Said në Egjipt kur u vë në zjarr rreth 27 kilometra në veri të ishullit holandez Ameland.

Vendndodhja e saj është afër një grumbulli ishujsh holandezë dhe gjermanë të njohur për turistët në detin e cekët Wadden. Kjo zonë është e listuar në Trashëgiminë Botërore dhe përshkruhet nga UNESCO si "një nga zonat më të rëndësishme për zogjtë shtegtarë në botë".

Shkaku i zjarrit nuk dihej menjëherë dhe nuk ishte e qartë se si ndodhi vdekja e anëtarit të ekuipazhit.

Rusia dhe Bjellorusia nuk ftohen në Lojërat Olimpikë të Parisit

MOSKË, 26 KORRIK - Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, të mërkurën ftoi zyrtarisht 203 vende, por edhe jo Rusinë dhe Bjellorusinë, për të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë të Parisit, të cilat do të fillojnë pas një viti.

Bach kishte thënë edhe më parë se as Rusia dhe as aleati i saj në pushtimin e Ukrainës, Bjellorusia, nuk do të ftoheshin si ekipe. Megjithatë, IOC-ja e ka lënë derën e hapur që atletët rusë dhe bjellorusë të konkurrojnë si atletë neutralë në Lojërat Verore 2024 pa skuadrat e tyre.

IOC-ja ka qenë nën presion për t'i ndaluar sportistët rusë dhe bjellorusë të garojnë, madje



edhe nëse e bëjnë këtë nën një flamur neutral, shkaku i pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia.

Ministri i Sportit i Ukrainës, Vadym Guttsait, e ka akuzuar IOC-në për "standarde të

dyfishta" për sugjerimin që atletët rusë dhe bjellorusë mund të garojnë në Paris, ndërsa ministri i qeverisë, Oleh Nemchinov, njoftoi në prill se atletët ukrainas nuk duhet të lejohen të konkurrojnë në garat

kualifikuese për Lojërat Olimpikë të Parisit 2024 nëse rusët marrin pjesë.

IOC kritikoi Ukrainën për "privimin e atletëve të saj nga shansi për t'u kualifikuar në Lojërat Olimpikë Paris 2024 dhe për ta bërë popullin ukrainas krenar", dhe e ritheksoi këtë qëndrim në deklaratën e fundit. "Në një sport kaq të politizuar, Lojërat Olimpikë universale nuk do të jenë më të mundshme", thuhet në deklaratën e IOC.

Bach është në një vizitë treditore në kryeqytetin francez, ku do të mbahen Lojërat Olimpikë verën e ardhshme. "Në përputhje me Kartën Olimpikë, është nderi dhe kënaqësia ime e madhe ta

shënoj këtë moment historik të rëndësishëm sot duke ftuar atletët e botës të mblidhen së bashku në Paris, Francë, për të festuar Lojërat e Olimpiadës së 33-të", tha Bach.

Bach tha se ai "sapo kishte marrë informacion të shkëlqyeshëm në lidhje me përgatitjet për Paris 2024" pasi vizitoi vendin e ndërtimit të Fshatit të Atletëve të martën. Më pas ai tha se konkurrentët do të ishin "shumë të lumtur" në atë fshat.

As Guatemala nuk u ftua në Lojërat Olimpikë sepse aktualisht është pezulluar për shkak të ndërhyrjes së sopusuar të qeverisë në pavarësinë e Komitetit Olimpik Kombëtar.

Pesë vjet pa Adem Demaçin

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Të mërkurën janë bërë pesë vjet që kur ndërroi jetë veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i njohur si Mandela i Kosovës.

Me prejardhje nga fshati Lupq i Podujevës, Demaçi lindi më 26 shkurt 1936 në Prishtinë, ndërsa më 26 korrik të vitit 2018 ka ndërruar jetë. Adem Demaçi ishte veprimtar për kauzën kombëtare në kohën e Jugosllavisë dhe luftonte për barazinë e Kosovës me republikat e tjera.

I njohur si simbol i rezistencës kombëtare, i ndjeri Adem Demaçi sot do të mbushte 87 vjet.

Për angazhimin e tij politik, Adem Demaçi vuajti 28 vjet me radhë në burgjet e Jugosllavisë. Pasi u lirua ai menjëherë vazhdoi aktivitetin politik.

Ai u quajt edhe Nelson Mandela i Evropës.

Përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale dhe përfaqësues të opozitës e kanë përkujtuar figurën e Demaçit në pesëvjetorin e ndarjes nga jeta.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se lufta për drejtësi, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe kauza për Kosovën Republikë

portretizohen më së miri në jetën dhe veprën e simbolit të rezistencës kombëtare - Adem Demaçi. "Liria e popullit ishte më e rëndësishme sesa ajo individuale. Historia e Demaçit është histori e vendosmërisë së palëkundur, guximit dhe vullnetit të paepur për të mbijetuar pavarësisht rrethanave. Përgjatë gati tri dekadave të burgut, ai mbajti peshën e padrejtësisë, duke

kultivuar humanizmin dhe ruajtur shpresën për një të nesërme më të mirë. Vetëmohimi i tij është dëshmi e rrugës së zorshme deri te liria dhe bërja e shtetit, ndaj e kujtojmë me respekt në këtë përvjetor e përherë!", ka thënë Osmani.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, me rastin e pesëvjetorit të ndarjes nga jeta të veprimtarit dhe intelektualit Adem Demaçi ka bërë homazhe në nderim të jetës dhe veprës së tij.

Kryeministri ka theksuar se bashkë me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufcën, me zëvendësin e bacës Adem si përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së në Prishtinë e vitit 1998-1999, ish-të burgosurin politik Skënder Kastrati dhe kolegun e tij nga zyra e UÇK-së, Milot Cakajn, vendosën lule në përkujtim të një figure aq të jashtëzakonshme unike të kombit shqiptar. "Sot u mbushën pesë vjet kur baca Adem shkoi në amshim dhe sigurisht që kemi pikëllim dhe mallëngjim që nuk e kemi më bacën Adem por edhe kemi krenari e mirënjohje që e patëm dhe e njohëm, që punuam dhe mësuam prej tij", ka thënë kryeministri Kurti.

Jeta dhe vepra e bacës Adem, idetë dhe udhëzimet tij, shtoi më tej ai, na mbushin me përgjegjësi dhe vetëbesim njëkohësisht.

Homazhe te varri i Demaçit ka bërë edhe kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliqi, i cili ka theksuar se Adem Demaçi do të kujtohet e nderohet gjithmonë ndër breza si një prej veprimtarëve më të devotshëm që njih historia në kauzën kombëtare.

Po ashtu, në 5-përvjetorin e



ndarjes nga jeta të veprimtarit Adem Demaçi, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica, së bashku me veprimtarë të tjerë, ka bërë homazhe në kujtim dhe nderim të tij.

"Sot e përgjithmonë nderojmë kujtimin për Nderin e Kombit, Bacë Adem Demaçin, i cili ishte frymëzues për të gjithë ne që u angazhuam për liri dhe të drejtat e shqiptarëve. Ai jeton në zemrat tona dhe është pjesë e pashlyeshme e historisë sonë kombëtare. Kujtesa e tij do të jetë një shkëndijë e përjetshme që do

të na shoqërojë në sfidat e ardhshme, siç e bëri ai gjatë jetës së tij të shenjtë për kombin tonë", ka thënë deputeti Reçica.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se pesë vjet më parë humbëm një nga personalitetet më të veçanta dhe më të guximshme të popullit tonë. "Ai u largua vetëm fizikisht, sepse, tashmë Adem Demaçi u përket epokave", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se nëpërmjet karakterit dhe vullnetit të palëkundur për të sakrifikuar lirinë e tij për lirinë e të tjerëve, baca Adem e transformoi Kosovën, duke nxitur shpirtin liridashës në çdo familje dhe në çdo individ. "Personalisht, edhe unë jam një nga miliona qytetarë shqiptarë të cilët janë frymëzuar nga jeta e Adem Demaçit. Meqë nuk do të kemi një personalitet të dytë si ai, na takon neve të përcjellim sa më mirë shembullin që ai dha: Të marrim vendime për të udhëhequr jo nga urrejtja, por, nga dashuria dhe të përpqemi për një të ardhme që është e denjë për sakrificën e tij. Prandaj, sot, në vend të përkujtimit, le të jemi falënderues që Adem Demaçi ishte pjesë e kombit tonë dhe jetoi për ne e mes nesh", është shprehur Krasniqi.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se secili vit i jetës së bacës Adem ishte frymëzim për brezat e sakrificës, që kulmoi me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Ai nuk

u ndal asnjëherë së angazhuari për realizimin e idealeve për të cilat kishte kaluar tri dekada në burgjet famëkeqe serbe. Baca Adem do të mbetet përgjithmonë në kujtesën historike si njeriu i hekurt që nuk e mposhtën as torturat më mizore të regjimit serb", ka deklaruar Haradinaj. Adem Demaçi udhëhoqi Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (KMDLNJ) nga viti 1990 deri në vitin 1995.

Në vitin 1991 u nderua nga Parlamenti Evropian me Çmimin Saharov.

Gjatë periudhës 1998-1999, kur mbaheshin takimet në Rambouillet për të ardhmen e Kosovës, ai ishte zëdhënës politik i UÇK-së. Ishte njëkohësisht kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (2005-2007).

Sot njerëzit e rezistencës kombëtare identifikohen me emrin e Adem Demaçit, sepse ai me punën dhe me veprën e tij u bë simbol i unifikimit për ruajtjen e kombit shqiptar mbi pesë dekada.

Adem Demaçi me jetën dhe veprën e tij u shndërrua në një personalitet të përmasave të historisë së përgjithshme njerëzore, ku bën pjesë edhe historia jonë kombëtare. Ai ka shkruar romanin "Gjarprijt e gjakut" i cili u ndalua nga regjimi ish-komunist. Ai e pa dritën vetëm pas viteve nëntëdhjetë.

Pasditën e 26 korrikut të vitit 2018 Demaçi ndërroi jetë. Në nderim të tij u organizuan shumë aktivitete shtetërore si dhe u mbajtën tri ditë zie në Kosovë.





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI MBAN KONFERENCË PËR MEDIE, FLET PËR SITUATËN NË VERI

Kurti: Nuk mund të ketë zgjedhje para se të shtensionohet situata në veri

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ka bërë me dije se zgjedhjet në katër komunat në veri nuk mund të zhvillohen pa u shtensionuar situata në atë zonë. Por, ai ka thënë se Kosova është duke i kryer përgatitjet për zgjedhje të parakohshme në këto katër komuna. “Nuk besoj se dikush pret që pa u bërë deeskalimi i plotë të ketë zgjedhje në veri”, ka thënë Kurti

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhjet në katër komunat në veri të Kosovës nuk mund të zhvillohen pa u shtensionuar situata në atë zonë. Por, ai shtoi se Kosova është duke i kryer përgatitjet për zgjedhje të parakohshme në këto katër komuna. “Nuk besoj se dikush pret që pa u bërë deeskalimi i plotë të ketë zgjedhje në veri, por natyrisht që ne e vazhdojmë punën edhe më tutje. Ne jemi duke u përgatitur të ketë zgjedhje të parakohshme”, ka thënë Kurti.

Zgjedhjet e parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës - Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë të Veriut - janë kërkuar nga komuniteti ndërkombëtar për shtensionim të situatës në veri, që është përkeqësuar dy muaj më parë. Në këto komuna të banuara me

shumicë serbe, kryetarët e rinj të dalë nga zgjedhjet e bojkotuara nga Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - janë shqiptarë. Serbë lokalë kanë protestuar që nga 29 maji kundër hyrjes së tyre në objektet komunale.

Më 11 korrik Bashkimi Evropian konfirmoi se Kosova do ta mbështesë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore si pjesë e veprimeve për ta shtensionuar situatën.

Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës është “e interesuar që zgjedhjet të mbahen sa më parë”, por shtoi se “kjo që do të ndodhë është jashtë përvojës sonë institucionale”. “Në do të sigurohemi që kjo përvojë e re që do ta kemi me ndërprerjen e mandatit të këtyre kryetarëve në veri ta ketë mbështetjen dhe garancitë ligjore dhe procedurale. Pra, duhet të sigurohemi që procesi i tillë të jetë aq i sigurt sa që të jetë i pasfidueshëm në kuptimin legal dhe juridik”, ka thënë Kurti.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune.

Ky peticion, sipas Krasniqit, më pas do të dërgohej në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), që do ta verifikonte atë dhe më pas do të niste një referendum me pyetjen se a duhet të shkarkohet kryetari. “Në këtë referendum duhet të marrin pjesë të paktën 50 për qind e trupës votuese, plus një. Kështu që kjo është baza ligjore që del dhe buron nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale”, tha Krasniqi.

Më parë zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, kishte thënë se nuk është i sigurt që ekziston një bazë e përshtatshme ligjore për shpalljen e tyre.

Gjatë konferencës, Kurti, gjithashtu, tha se pret që masat

Qeveria e Kosovës miraton pako të sanksioneve ndaj Ruisë

Qeveria e Kosovës ka miratuar pakon e 11-të të sanksioneve të Bashkimit Evropian ndaj Ruisë dhe Bjellorusisë lidhur me luftën në Ukrainë të propozuar nga Ministria për Punë të Jashtme dhe Diasporë (MPJD).

Këshilli i Bashkimit Evropian e kishte miratuar pakon e 11-të të sanksioneve kundër Ruisë për pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 23 qershor. Në këtë pako ishin zgjeruar disa kufizime të mëhershme dhe ishin shtuar disa dhjetëra entitete të reja në listën e sanksioneve.

Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës më 26 korrik, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se qeveria po plotëson vendimin për zbatim të sanksioneve ndërkombëtare “në përputhje me masat e reja kufizuese të Bashkimit Evropian”. Pas përshkrimit të pakos nga ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla, qeveria e miratoi këtë pako në atë që Gërvalla e përshkroi si “dëshmi të fuqishme të përkushtimit të Kosovës për drejtësi dhe paqe jo vetëm në rajonin tonë, por në mbarë

botën”. “Kosova qëndron e palëkundur në krahë të partnerëve të saj, pra ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian”, tha Gërvalla.

Përmes kësaj pakoje të 11-të të sanksioneve, Bashkimi Evropian kërkoi t’ua pamundësojë vendeve dhe kompanive të tjera t’i anashkalojnë masat e vendosura më parë, duke i mbyllur zbrazëtirat në atë mënyrë që mallrat dhe teknologjia kyçe për përpjekjet luftarake të Ruisë të mos arrijnë në Rusi nëpërmjet vendeve që tregtojnë me BE-në. “Sisteme janë duke u vendosur në disa vende për monitorimin, kontrollin dhe bllokimin e rieksporit. Shifrat anormale të tregtisë për disa produkte/vende shumë specifike janë dëshmi e fortë se Rusia po përpjeket në mënyrë aktive t’i anashkalojë sanksionet. Kjo kërkon që ne t’i dyfishojmë përpjekjet tona për trajtimin e anashkalimit dhe t’u kërkojmë fqinjëve tanë bashkëpunim edhe më të ngushtë”, thuhej në deklaratën e BE-së.

Reagim i KMDLNj-së

16 milionë për çlirimtarët qenkan shumë, qindra milionë euro për rrymën në veri nuk përmenden. Çfarë poshtërsie!

Në Burgun e Gjykatës Raciste Speciale në Hagë po mbahen peng tetë shtetas të Kosovës, të gjithë shqiptarë. Salih Mustafa, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati janë dënuar me dënime kapitale-drakonike gjë që nuk e ka bërë një diversion të tillë juridik as Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish Jugosllavinë në Hagë i cili ka qenë shumë më i ekuilibruar, si gjatë arrestimeve e, në veçanti gjatë shqiptimit të dënimeve. Ndërsa, sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria, Tribunali i Hagës ka qenë Akademi e respektimit të të drejtave të njeriut krahasuar me Gjykatën Speciale Raciste. Shtetasit e Kosovës janë kidnapuar - arrestuar në Kosovë dhe Belgjikë dhe, përkundër vullnetit të tyre janë dërguar në Hagë, që, për familjet e tyre, sidomos për të moshuarit dhe fëmijët paraqet vështirësi t'i vizitojnë. Fillimisht kishin probleme të natyrës burokratike të pajisen me viza afatgjata, vendosje si dhe probleme tjera gjatë udhëtimit. Vizitat "humanitare" për të burgosurit ishin skajshmërisht degraduese, refuzoheshin pa ndonjë arsye dhe shkelnin të drejtat elementare të personave të privuar nga liria duke ua mohuar mbajtjen e vazhdimësisë së

rregullt me familje dhe duke ua rrezikuar mjedisin social që është njëri ndër kushtet themelore për ruajtjen e shëndetit mendor dhe fizik.

Deri më tani pengjet e Kosovës që po mbahen në Hagë janë mbështetur, qoftë për të siguruar mbrojtje ligjore apo për të mbështetur familjet gjatë vizitave me më shumë se 16 milionë euro e që, kohë pas kohe përsëritet nga MD-ja dhe nga kryeministri Kurti thuaja që e kanë bërë dhe po e bëjnë një sakrificë nga xhepi i tyre e jo që është detyrim shtetëror që është rregulluar me ligj. Realisht, shteti i Kosovës ka detyrim ndaj cilitdo shtetas të Kosovës që mbahet në burgjet e shteteve tjera, qoftë duke siguruar asistencë ligjore apo duke përkrahur familjet nëse ato nuk kanë mundësi materiale. Kroacia, vetëm për mbrojtjen e gjeneralit Ante Gotovina ka ndarë 33 milionë euro dhe asnjëherë dhe askush nuk e ka kundërshtuar këtë vendim të shtetit kroat. Ndërkaq, në Kosovë edhe para se të votohej Ligji për Mbështetje të të akuzuarve dhe të dënuarve nga Gjykata Raciste Speciale në Hagë, kishte kundërshtime nga një pjesë e së ashtuquajturës shoqëri civile dhe nga opozita që tradicionalisht ishin kundër luftës dhe kundër UÇK-së. Edhe së voni dëgjoheshin zëra, si nga



burimet e vjetra ashtu edhe nga pozita që duhet të rishqyrtohet përkrahja materiale e personave që po mbahen peng në Hagë, të gjithë shqiptarë dhe shtetas të Kosovës dhe, po të mos ishte detyrimi ligjor që del nga Ligji përkatës, të privuarit nga liria do të mbeteshin pa përkrahje ligjore sikur që familjarët nuk do të kishin mundësi t'i vizitojnë anëtarët e familjeve të tyre. Nuk kanë asnjë përgjegjësi familjarët pse ua kanë dërguar familjarët e burgosur aq larg por shteti ka përgjegjësi të sigurojë të gjitha kushtet që ata të vizitohen rregullisht, pa iu vënë asnjë pengesë materiale e as ligjore. Ose duhet të angazhohet që të dënuarit të kthehen në vuajtje të dënimit në Kosovë, nëse thuhet se Gjykata Speciale është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës. Realisht, përgjegjësia kryesore është e deputetëve të Kuvendit të

Kosovës që nuk kanë guxim qytetar e as profesional të reagojnë për shkeljet e mëdha të të drejtave të njeriut të pengjeve të Hagës sikur edhe të kërkojë transparencë dhe llogaridhënie nga kjo Gjykatë e jo që gjykimi të mbahet në terr informativ duke ofruar informata selektive e që janë në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut dhe një procesi të drejtë, të paanshëm dhe transparent. Gjykimi i deritashëm ndaj Hashim Thaçit, president, Jakup Krasniqit, kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit, kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe Rexhep Selimit, kryetar i GP të VV-së ka qenë thuaja krejtësisht i mbyllur për publikun, me një fjalë ka qenë dhe mbetet një proces gjyqësor i privatizuar nga kryeprokurori i Speciales, kryetari i trupit gjykues dhe bossja e gjykatës, Ekaterina Trandafilova. As procesi e sidomos

trajtimi i personave të privuar nga liria nuk monitorohet nga ndonjë organizatë apo institucion i pavarur për të drejtat e njeriut përveç se bëhet monitorimi nga distanca. Ky është rasti i parë i mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, madje edhe Gjykata në Nyremberg në Gjermani pas përfundimit të luftës së dytë botërore ka qenë më transparente.

Deklaratat nga MD-ja dhe kryeministri për shpenzimin e 16 milionë eurove për 8 të akuzuar dhe të dënuar dhe familjet e tyre paraqet një bizantinizëm perfid aq më parë që në të njëjtën kohë e heshtin faktin se për rrymën e serbëve dhe të tjerëve në veri të Kosovës, shërbimet tjera dhe rrogat që paguajnë për vite për strukturat e "integruara" paralele, që nga përfundimi i luftës paguajnë me dhjetra miliona euro gjatë një viti kalendarik. Krahasoni tash 16 milionë që paguhen për ata që e bënë luftën, e sollën lirinë, e shpallën pavarësinë dhe e bënë shtetin, me qindra milionë euro të shpenzuara për rrymën dhe shërbime të tjera si dhe paga për ata që e luftuan Kosovën, ishin kundër lirisë, ishin kundër pavarësisë, ishin kundër shtetit dhe me çdo kusht duan ta shkatërrojnë shtetin. Nuk është asgjë tjetër përveç se është poshtërsi dhe manipulim!



Shefi i BE-së: Masat ndaj Kosovës janë të përkohshme dhe të kthyeshme

Prishtinë, 26 korrik - Shefi i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka takuar të mërkurën anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë. Takimi është mbajtur me dyer të mbyllura, ndërkaq shefi i BE-së në Kosovë në "Twitter" ka shkruar se në komision ka njoftuar se masat e BE-së janë të përkohshme dhe të kthyeshme, por nevojitet angazhim konstruktiv për ta

shpërkallëzuar situatën në veri. "Patëm një shkëmbim të mirë me Komisionin për Punë të Jashtme për zhvillimet e fundit dhe situatën në veri. Shpjegova se masat e BE-së janë të përkohshme dhe të kthyeshme, por nevojitet një angazhim konstruktiv për ta përmbytur shpërkallëzimin siç kërkohet nga deklarata e BE-së e 3 qershorit", ka shkruar Szunyog.

ndëshkuese të ndërmarrja nga Bashkimi Evropian ndaj Kosovës të tërhiqen sa më shpejt. Masat ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave

bilaterale, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Burimet diplomatike nga BE-ja i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se heqja e masave ndëshkuese që Bashkimi Evropian i ka vendosur Kosovës do të varet nga zbatimi i obligimeve që ka marrë Prishtina dhe hapat e tjerë që priten nga

autoritetet në Kosovë për vazhdimin e përpjekjeve për t'i ulur tensionet në veri.

Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, dhe i dërguari i BE-së për dialogun mes dy vendeve, Miroslav Lajčak, arritën një pajtim për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës gjatë një takimi më 10 korrik në Bratisllavë. Kurti tha se "në veri të

Kosovës nuk mund të mohohet një lloj deeskalimi që tashmë ka ndodhur", por shtoi se tani Qeveria e Kosovës është e shqetësuar nga "potenciali i rrieskalimit". "Rieskalimi nuk varet prej nesh. Ju e kemi garanci Qeverinë e Kosovës, organet tona shtetërore, mua si kryeministër që me asgjë, asnjëherë, askund nuk kontribuojmë në eskalim", ka deklaruar Kurti, duke shtuar

se "nëse ka eskalim, atëherë adresa është Beogradi zyrtar". Një ditë më parë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se autoritetet në Kosovë nuk duan zgjedhje. "Lërimi ta bëjnë punën e tyre, por ata as nuk i duan ato zgjedhje, nuk duan asgjë", tha Vuçiqi pas ndjekjes së fazës përfundimtare të trajnimit të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura Serbe.

Haradinaj: Presionet dhe kërcënimet ndaj policëve të rinj në veri, të papranueshme

Prishtinë, 26 korrik - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar lidhur me linçimet që u janë bërë së fundmi policëve të rinj serbë në veri të Kosovës. "Presionet dhe kërcënimet ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera në veri,

që janë bërë pjesë e Policisë së Kosovës, janë të papranueshme dhe përpjekje për ta sabotuar shpërshkallëzimin dhe qetësimin e situatës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ai ka thënë se pjesëtarët e

komuniteteve pakicë, përfshirë këtu edhe serbët, duhet të lejohen të lirë në realizimin e të drejtave të tyre qytetare. "Qytetarët serbë dhe çdo pjesëtar i komuniteteve pakicë duhet ta konsiderojnë Kosovën si atdheun e tyre dhe të



Limaj përkujton dëshmorët e kombit Ymer Alushani dhe Ali Zogaj

MALISHEVË, 26 KORRIK - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i ka përkujtuar dëshmorët e kombit, Ymer Alushani dhe Ali Zogaj, në 25-vjetorin e rënies heroike. Limaj ka thënë se Alushani dhe Zogaj me dhjetëra bashkëluftëtarë tjerë u bënë digë e fuqishme për ta bllokuar Grykën e Llapushnikut për muaj të tërë dhe në këtë mënyrë i prishën shumë plane Serbisë. "Sot u bënë 25 vjet nga rënia heroike e dëshmorëve të kombit Ymer Alushani - komandant Voglushi dhe Ali Zogaj. 25 vjet më parë heroi i kombit, Ymer Alushani, ishte i pari që atë ditë vendosi trupin e tij bashkë me dëshmorin Ali Zogaj dhe dhjetëra bashkëluftëtarë të tjerë duke u bërë digë e fuqishme për ta bllokuar Grykën e Llapushnikut për muaj të tërë, dhe me mbylljen e Grykës iu prishën planet Serbisë për ta izoluar këtë pjesë të Kosovës. Rënia heroike e Ymer Alushanit, Ali Zogajt dhe disa bashkëluftëtarëve të tjerë ishte goditje dhe humbje e madhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por po kaq e madhe ishte vendosmëria për ta vazhduar luftën çlirimtare deri në fitore. Lavdi jetës dhe veprës së Ymer Alushanit, Ali Zogajt dhe të gjithë atyre që u flijuan për lirinë e Kosovës!", ka shkruar Limaj në rrjetet sociale.



Hamza pret në takim kryebashkiakun e Inegylit, diskutojnë për bashkëpunimin e dyanshëm



MITROVICË, 26 KORRIK - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, ka pritur në takim një delegacion nga shteti turk, i prirë nga kryetari i Bashkisë së Inegylit, Alper Taban. Kryetari Hamza dhe kryebashkiaku Taban e kanë vlerësuar shumë të rëndësishëm bashkëpunimin në mes të Mitrovicës dhe Inegylit, me të cilin qytet Mitrovica është e binjakëzuar.

Gjatë takimit është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për realizimin e projekteve të përbashkëta. Kryetari Hamza e ka falënderuar delegacionin turk për vizitën duke potencuar që shteti turk është mbështetës i mirë i Kosovës, ndërsa kryebashkiaku Taban mbetet mik i mirë i Mitrovicës. Delegacioni nga Turqia po qëndron në Mitrovicë në kuadër të manifestimit për shënimin e Ditëve të Diasporës.

30 hektarë në Suharekë i kalojnë në pronësi Ministrisë së Mbrojtjes

SUHAREKË, 26 KORRIK - Prona me sipërfaqe mbi 30 hektarë, e njohur si ish-"Damperi" në Suharekë, i kalon në pronësi Ministrisë së Mbrojtjes, e cila do të jenë në shërbim të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Vendimi është marrë në

mbledhjen e Qeverisë së Kosovës. "Në mbledhjen e 153-të të qeverisë u mor vendimi që prona me sipërfaqe mbi 30 hektarë, e njohur si ish-'Damperi', të kalojë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Kështu dhjetëra

hektarë do të jenë në shërbim të Forcës së Sigurisë së Kosovës për zhvillim të trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera të parapara në kuadër të planit operacional të FSK-së", ka bërë me dije ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.



Tahiri: Më e keqja, Kurti po e tërheq policinë në veri e ndëshkimet e ShBA-së nuk po hiqen

PRISHTINË, 26 KORRIK - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka reaguar sërish për situatën në veri. Ajo ka shkruar në "Facebook" se kryeministri Albin Kurti po mendon se duke tërhequr gradualisht policinë nga katër komunat në veri

populli nuk sheh por, në fakt, sipas saj, vetëm militantët e LV-së nuk shohin. Sipas Tahirit, çka është më e keqja, Kurti edhe po e tërheq policinë, ndërsa ndëshkimet e ShBA-së nuk po hiqen. "Kurti po mendon se duke tërhequr gradualisht policinë nga katër komunat në veri

populli nuk sheh por, në fakt, nuk shohin vetëm militantët e LV-së. Çka është më e keqja, edhe po e tërheq policinë, ndërsa ndëshkimet e ShBA-së nuk po hiqen. ShBA-ja as nuk i vendos lehtë sanksione një shteti mik siç është Kosova, as nuk i heq lehtë!", ka shkruar Tahiri.



'Enver Zymberi do të mbetet simbol i përjetshëm i sovranitetit dhe i ligjshmërisë në Kosovë'

PRISHTINË, 26 KORRIK - Të mërkurën është shënuar Dita Memoriale e Policëve të rënë në krye të detyrës. Kjo datë përkon me përvjetorin e rënies së zyrtarit policor heroit Enver Zymberi.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se 12 vjet më parë Enver Zymberi u vra nga strukturat kriminale të Serbisë gjatë një aksioni që po zhvillonte Policia e Kosovës në veriun e vendit tonë. "Enver Zymberi do të mbetet simbol i përjetshëm i sovranitetit dhe i ligjshmërisë në Republikën e Kosovës. Drejtësia dhe dënimi për vrasësit e tij është domosdoshmëri, ndërsa vijimësia e angazhimit të kolegëve të tij në çdo cep të Republikës sonë është shembulli më i mirë që kemi mes nesh. Emrin e tij do ta lartësojmë e nderojmë edhe sot, me zbulimin e pllakës së tij përkujtimore në Kampin e Policisë në 'Belvedere', të cilin do ta quajmë Kampi i Policisë 'Enver Zymberi'. Sot, bashkë me të, përkujtojmë 22 pjesëtarët e rënë të Policisë së Kosovës, në situata të ndryshme, sakrificat e të cilëve u bë njësoj shembull i brezave të rinj e gjeneratave të reja të Policisë së Kosovës, të cilat sa vijjnë e shtohen", ka thënë Kurti.

Edhe presidentja Vjosa Osmani ka përkujtuar heroin Enver Zymberi në 12-vjetorin e rënies. Ajo ka thënë se dymbëdhjetë vjet më parë polici Enver Zymberi ra në mbrojtje të integritetit territorial të Kosovës. "Sot e nderojmë guximin dhe sakrificën e heroit. Ai ishte mishërim i përkushtimit, guximit dhe vetëmohimit. Atij, sikurse edhe të



gjithë policëve të rënë në detyrë, u përkulemi për kontributin e çmuar për sigurinë tonë në çdo cep të vendit. Sikurse atëherë, ashtu edhe sot, Policia e Kosovës është mbrojtësja e palëkundur e kufijve të shtetit tonë nga agresioni i vazhdueshëm i Serbisë, prandaj duhet jo vetëm të respektohet, por edhe të vlerësohet e mbështetet maksimalisht për punën dhe sakrificën", ka thënë Osmani. Kryetari i PDK-së, Memli

Krasniqi, ka thënë se 12 vjet më parë, në mbrojtje të integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, Enver Zymberi sakrifikoi jetën. "Me të drejtë sot ai është hero i Kosovës së pavarur. Guximi dhe vepra e tij do të kujtohen ndër breza - si shembull i atdhedashurisë dhe profesionalizmit. Enver Zymberi nuk ishte aksidentalisht polic. Për të, uniforma e policisë ishte vetëm mënyra e tij për t'i shërbyer Kosovës me nder e

krenari - gjë të cilën e bëri deri në frymën e fundit", ka thënë Krasniqi.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit të vendit, siguria e qytetarëve dhe mbrojtja e rendit dhe ligjit, për Enverin ishin përtej jetës së tij. "Sakrificat e tij në shërbim të vendit dhe mbrojtjes së rendit kushtetues, do të mbetet frymëzim ndër breza", ka deklaruar Haradinaj.

Djali i Enver Zymberit: Më mungon shumë, shpresoj që një ditë ta vesh uniformën e policisë

Në 12-vjetorin e vrasjes së pjesëtarit të Forcave Speciale të Policisë së Kosovës, Enver Zymberi, varrin e vizitoi djali i tij, Sokoli. Aty ai rrëfeu për dhimbjen dhe mungesën që e ka për babanë e tij, teksa shpreson që një ditë do ta vesh uniformën e Policisë së Kosovës.

Në një rrëfim për "Ekonomia Online", Sokoli tha se vendin e prindit të tij s'mund ta zëvendësojë askush, por që po ia del falë familjarëve të tij. "Po, normalist që është e vështirë por, falë Zotit, nuk jam vetë, e kam nënën, i kam motrat e xhaxhallarët. Vendin e tij nuk mund ta zëvendësojë askush, por jemi bërë të fortë", u shpreh ai.

Sokoli shpreson që një ditë ta veshë uniformën e Policisë së Kosovës. "Padyshim që jam duke punuar në atë drejtim dhe shpresoj që një ditë do ta vesh uniformën e Policisë së Kosovës", ka thënë Sokoli.

Qeveria emëron Bordin e ri të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore

PRISHTINË, 26 KORRIK - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka aprovuar propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë për zëvendësimin e përbërjes së Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, që do të jetë edhe pjesë e Bordit, ka thënë se zëvendësimi

i Bordit është në përputhje me ligjin.

Bordi i ri i fondit të sigurimeve shëndetësore do të ketë shtatë anëtarë. Përveç Vitisë, në Bord janë edhe Hekuran Nikçi (përfaqësues nga Ministria e Financave), Besnik Fetahu (po ashtu nga Ministria e Financave), Kastriot Meça (përfaqësues Oda e

Profesionistëve Shëndetësorë), Ardian Shefkiu (përfaqësues nga Shërbimi Spitalor Klinik e Universitar i Kosovës), Izet Sadiku (Asociacioni i Komunave të Kosovës) dhe Afrim Maliqi (Shoqata e Pacientëve).

Emërimi është bërë me të gjitha votat për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.



Dhoma e Tregtisë kërkon që të përmirësohen kushtet në vendin e punës

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Vlerësimi i riskut në vendin e punës, mundësitë e zhvillimit të biznesit në vend, përmirësimi i kushteve në vendin e punës si dhe ikja e punëtorëve jashtë vendit, ishin disa nga çështjet që u ngritën në takimin e përfaqësuesve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë me kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi. Përfaqësueset e Dhomës së Tregtisë u shprehën të hapura për bashkëpunim profesional me Inspektoratin e Punës me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe inputeve drejtpërdrejt nga bizneset në mënyrë që të tejkalohen sfidat që hasin operatorët ekonomikë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Drejtoresha e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, Zana Beqiri, ka theksuar se me

kërkesën e bizneseve DHTIK-ja ka në fokus ngritjen e vetëdijes për respektimin e ligjit, respektivisht rregulloreve të punës nga ana e bizneseve dhe punëtorëve. Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi, ka bërë me dije se është i gatshëm për bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, ku i njëjti ka rekomanduar mbajtjen e trajnimeve me qëllim të këshillimit të bizneseve si punëdhënësve dhe punëmarrësve rreth përgjegjësisë dhe respektimit të të drejtave në vendin e punës. Përfaqësueset e Dhomës së Tregtisë kanë thënë se besojnë se Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje përmirësimit të kushteve të punës në vend. "Kjo konsiderojmë mund të realizohet përmes masave të



ndryshme siç janë përmirësimi i mekanizmave kontrollues, rritja e personelit në inspektoratin e punës, certifikimi i trajnuesve profesionistë të punësimit etj. DHTIK konsideron se krahas

projekteve për përmirësimin e cilësisë së produkteve që ndihmon në rritjen e tregut, të rinjtë kosovarë duhet që gjithashtu të ndryshojnë perceptimin e mjedisit të punës në vend, në mënyrë që

të zvogëlojmë numrin e të rinjve që lëshojnë vendin në kërkim të një mjedisi që ofron mirëqenie dhe respektim më të madh të ligjit", kanë theksuar përfaqësueset e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë.

ATK-ja nis zbatimin e projektit "Personat e pasur"

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua ka rikujtuar të gjithë personave të cilët krijojnë të ardhura, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të obliguar t'i deklarojnë dhe t'i paguajnë saktë detyrimet tatimore. Bazuar në Planin Strategjik 2022-2026 dhe Planin e Trajtimin të Rreziqeve për vitin 2023, ATK-ja ka hartuar planin e veprimtimit për ta përmirësuar përmbushjen tatimore të personave të pasur lidhur me detyrimet e tyre tatimore për Tatimin në



të Ardhurat Personale, të cilat i përcakton legjislacioni tatimor. Përmes këtij plani, ATK-ja do të kryejë aktivitete me qëllim të identifikimit të personave të pasur, të cilët

nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë saktë detyrimet tatimore. Qëllimi i projektit "Personat e pasur" është identifikimi i personave të pasur duke

përdorur bazë të të dhënave në formë sistemi/platforme e cila mundëson ndërlidhjen me institucione qeveritare, joqeveritare, financiare me qëllim të trajtimit tatimor të kësaj kategorie, rritjen e numrit të deklarimeve dhe pagesës së tatimit nga kjo kategori e tatimpaguesve, si dhe zvogëlimin e hendekut tatimor si rezultat i mosdeklarimit të të ardhurave nga personat me të ardhura të larta. Fushëveprimi i këtij projekti do të jetë i shtrirë në kategorinë e personave si në vijim: Kategoria I - Personi, pasuria e të cilit është mbi 1 milion euro deri në 5 milionë

euro; Kategoria II - Personi, pasuria e të cilit është mbi 5 milionë euro deri në 10 milionë euro; Kategoria III - Personi, pasuria e të cilit është mbi 10 milionë euro deri në 20 milionë euro; dhe Kategoria IV - Personi, pasuria e të cilit është mbi 20 milionë euro. Administrata Tatimore e Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë personave që t'i përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor, gjegjësisht ta deklaroni dhe ta paguani saktë tatimin, në të kundërtën do të ndërmerren masat e përcaktuara me legjislacionin tatimor.

Anketa e Pulsit Publik, Mustafa: 82.19 % e qytetarëve të Kosovës nuk janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të vendit


PRISHTINË, 26 KORRIK - Koordinator i Departamentit për Financa në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Arben Mustafa, ka thënë se Anketa e Pulsit Publik, publikuar nga UNDP, raporton se 82.19 % e qytetarëve të Kosovës nuk janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të vendit. Mustafa në "Facebook" ka shkruar se këto të dhëna paraqesin një ilustrim faktik të dështimit të Qeverisë së Kosovës. Nga qytetarët e anketuar, 74.6 % kanë listuar

papunësinë, varfërinë, rritjen e çmimeve dhe çmimet e produkteve bazë si problemet kryesore me të cilat ballafaqohet vendi. Këto të dhëna paraqesin një ilustrim faktik të dështimit të kësaj qeverie për t'i përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëve të Kosovës dhe nevojën urgjente që qeveria ta kthejë vëmendjen drejt ofrimit të zgjidhjeve për problemet kyçe me të cilat ballafaqohen qytetarët", ka shkruar Mustafa. Më tej, ai ka thënë se, përveç se

janë të shqetësuar me papunësinë e lartë që po mbretëron në Kosovë, qytetarët janë shprehur shumë të pakënaqur edhe për sa i përket punësimit në baza meritore në sektorin publik. "Rezultatet e anketës tregojnë se 78 % e qytetarëve besojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Prandaj, bazuar në rezultatet e këtij publikimi, lirisht mund të konstatohet se me këtë qeveri nuk ka as punësim e as drejtësi në punësim", ka përfunduar ai.



Teoria e kaosit



Teoria e kaosit është ligj i shpallur nga James Yorke dhe na kujton një fakt thelbësor: bota nuk ndjek një model të saktë dhe të parashikueshëm; duam apo s'duam; në jetën tonë ekziston edhe kaosi, kjo hapësirë e vogël që i është lënë rastësisë ku është thuhet e pamundur të parashikosh efektin e ngjarjeve të caktuara.

Është mjaft e zakonshme të lidhet teoria e kaosit me degët e saj mëmë: matematika dhe fizika. Megjithatë, shpesh harrojmë se këto shkencë kanë një implikim të drejtpërdrejtë në jetën tonë të përditshme; në të vërtetë ka shumë pak sektorë që kanë ndikim të njëjtë në sjelljen dhe njohuritë tona.

Vetë James Yorke e përmbledh rëndësinë e teorisë së tij në një fjali të thjeshtë: njeriu duhet të jetë i përgatitur për të ndryshuar planet në çdo moment.

Secili prej nesh ka një shkallë të caktuar tolerance ndaj pasigurisë. Duke u nisur nga një prag i caktuar, truri ynë kalon në "modalitet alarmi" ndaj asaj që mund të ndodhë.

Ne e preferojmë stabilitetin, duke ditur se dy plus dy janë katër dhe se ajo që na rrethon dhe kemi sot do

të jetë aty edhe në të nesërmen tonë. E gjithë kjo na ofron një ekuilibër emocional falë të cilit jemi në gjendje të shijojmë jetën, duke mbajtur gjithçka nën kontroll.

Megjithatë, teoria e kaosit e mbron një provë. Jeta dhe rrjedha e saj nuk korrespondojnë me ecurinë ritmike dhe të përsosur të një ore. Të parashikueshmet dhe të pakontrollueshmet gjenden gjithmonë brenda dhe rreth nesh. Është ajo shpata e Damokleut që mund të na godasë në çdo moment. Është ajo flutura që sot fluturon mbi Shtetet e Bashkuara dhe më vonë mbërrin në Evropë në formën e një krize ekonomike. Është ai topi i bardhë që ne goditëm në bilardo dhe që godet topat e tjerë duke i bërë ata të lëvizin, ndonjëherë në drejtime të papritura...

Teoria e kaosit na thotë se rezultati i një ngjarjeje varet nga disa variabla: ato, sjellja e të cilëve nuk është gjithmonë e parashikueshme me saktësi totale. Gjithmonë ka një kufi për gabim, një hapësirë për kaos, një valëvitje që ndryshon gjithçka në momentin e fundit. Sepse, ndonjëherë, një ndryshim i vogël gjeneron një efekt të përmasave të

mëdha.

Ka nga ata që argumentojnë se teoria e kaosit është një nga fushat më të mrekullueshme të matematikës moderne. Ajo shkencë përipiqet të parashikojë sjelljen e sistemeve në thelb të parashikueshme.

Ne mund të imagjinojmë reagimet ndaj kësaj teorie pasi, deri vonë, qëllimi i botës shkencore ishte të eliminonte variablin e pasigurisë në mënyrë që të ishte në gjendje të përshkruante me saktësi sjelljen e pothuajse çdo gjëje.

Megjithatë, në ditët e sotme ne e pranojmë këtë diferencë në të cilën rastësia dhe e parashikueshmja, në një moment të caktuar mund të ndryshojnë gjithçka. Kjo, në fakt, u zbulua nga meteorologu dhe matematikani Edward Lorenz në vitin 1961, kur ai u përpoq të krijonte një sistem kompjuterik për të parashikuar motin. Papritur ai e kuptoi se për shkak të një gabimi të përafërit në numra, i gjithë sistemi kishte filluar të shfaqte sjellje qartësisht të parashikueshme. Më vonë kjo përvojë u përdor për të formuluar efektin e famshëm të fluturës.

Fenomenet kaotike janë të shumta jo vetëm në natyrë, por edhe në

biologji. Nuk ka asnjë zonë të lirë nga kjo sjellje e parashikueshme. Dukuritë kaotike ndodhin çdo ditë pothuajse pa e kuptuar: në ekonomi, termodinamikë, astronomi dhe madje edhe psikologji.

Tani e dimë se çdo shqetësim i vogël në trurin tonë (siç është një ndryshim në një neurotransmetues) mund të rezultojë në ndryshime shumë dramatike në sjellje. Teoria e kaosit dramohet edhe në psikiatri. Ndonjëherë kur pacientit i jepet një ilaç, ekziston një shans i vogël që efekti i vërejtur të jetë i kundërt nga ai i pritur.

Si të zbatohet teoria e kaosit në jetën e përditshme?



Në jetën tonë të përditshme të gjithë duhet të shmangim kaosin. Vetëm kështu ndihemi të sigurt, vetëm kështu mund të ndërtojmë një jetë ku e parashikueshmja do të na lejojë të largohemi nga shtëpia pa frikë dhe të jemi në gjendje të shikojmë të ardhmen me besim. Siç na shpjegon James Yorke, babai i kësaj teorie, gjëja më e mirë për të bërë është të jesh gati për të ndryshuar planet në çdo moment.

Ky parim është i lidhur ngushtë me një teori tjetër aktuale. Po flasim për teorinë e mjellmës së zezë, të formuluar nga eseisti, ekonomisti dhe matematikani Nassim Nicholas Taleb.

Në librin e tij interesant, i cili mban të njëjtin emër me teorinë, ai na kujton se shumica prej nesh i nënshtrohen një botëkuptimi ku gjithçka, në pamje të parë, duket e parashikueshme. Megjithatë, në një moment të caktuar lind e papritura, e parashikueshmja, kaotikja... ajo erë që nuk e prisnim. Një ngjarje e parashikueshme që jemi të detyruar ta pranojmë dhe ta racionalizojmë.

Megjithatë, duhet thënë se në vend që të veprojmë vetëm kur ky kaos shpaloset para syve tanë, duhet të jemi të përgatitur. James Yorke na kujton se njerëzit që arrijnë sukses dhe lumturi janë ata që kanë gjithmonë një plan "B" në dorë.

Le t'i përipiqemi të zhvillojmë një mentalitet fleksibël dhe një qasje ku nuk reagojmë vetëm ndaj ngjarjeve. Le t'i përqafojmë me kuriozitet dhe pranim, sepse shumë herë është në kaos që lindin mundësitë. Në fund, të jesh i përgatitur për të papriturat do të thotë të kalosh nëpër të njëjtat ulje dhe ngritje të jetës. /bota.al/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova lufton deri në fund ndaj Danimarkës, por nuk mjafton

“Epoka e re”

PRISHTINË, 26 KORRIK - Kosova është mundur nga Danimarka me rezultat 82:75 (27:16, 17:27, 25:22, 13:10), në një ndeshje ku fituesi nuk është ditur deri në çastet e fundit. Ndeshjen më mirë e nisën vendasit me një seri prej 13:0, ndërsa më pas kishin epërsi në 14 pikë, 22:8, kurse me tre treshe radhazi nga Musab Mala, Dardanët rikthehen, duke afruar shifrat në 27:16. Në periudhën e dytë, danezët sërish u shkëputën në 39:21, por kësaj radhe, Dardan Berisha kundërpërgjigjet, me një super ndeshje, kurse në fund të pjesës së parë, “Dardanët” ngushtuan shifrat në 44:43. Në fillim të periodës së tretë, Kosova kaloi për herë të parë në epërsi 51:53. Ndeshje e baraspeshuar u zhvillua në këtë pjesë, ku shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 69:65. Kosova ishte e kufizuar me largimin e dy qendra Lis Shoshi dhe Dardan Kapiti me pesë gabime personale, por luftuan deri në fund, ndërsa rezultati përfundimtar ishte 82:75. Te Kosova u dalluan Dominic Artis me 23 pikë, Dardan Berisha me 13, Erjon Kasatri me dhjetë e Drilon Hajrizi me nëntë. Kosova ka një fitore e një humbje, ndërsa danezët dy fitore në Rrethin e Tretë Parakualifikues për “Eurobasket 2025”. Ndeshja e ardhshme për “Dardanët” është kundër Zvicrës, më 29 korrik në Fribourg.

‘Dardanët’ e rinj pësojnë nga Qipro

Kosova U16M është mposhtur nga Qipro në gjysmëfinale me rezultat 49:74 (9:28, 7:25, 15:10, 18:11). Kjo



është humbja e parë për “Dardanët” në Kampionatin Evropian, Divizioni C, që po zhvillohet në Prishtinë. Tani “Dardanët” do të luajnë për vendin e tretë kundër Andorrës nga ora 17:30, kurse finalja zhvillohet ndërmjet Qipros dhe Azerbajxhanit. Mal Tusuni shënoi 12 pikë për Kosovën, kurse nga dhjetë shënuan Lis Binishi

dhe Ben Basha. Në gjysmëfinalen e parë fitore ka shënuar Azerbajxhani ndaj Andorrës me rezultat 87:64. Gjatë ditës janë zhvilluar edhe ndeshjet për vendin pesë deri nëntë, ku Armenia ka fituar bindshëm ndaj Maltës me shifrat 93:36, ndërsa fitore arriti edhe San Marino ndaj Gjibraltarit 65:48.

Visar Kastrati ndan drejtësinë në ndeshjen Gent - Zilina

PRISHTINË, 26 KORRIK - UEFA vazhdon t'i delegojë gjyqtarët e Kosovës në ndeshjet e kompeticioneve të saj, duke i vlerësuar për profesionalizmin dhe aftësitë e tyre në fushën e ndarjes së drejtësisë. Kësaj radhe gjyqtari i njohur Visar Kastrati do ta ketë nderin ta drejtojë ndeshjen e rrethit të dytë të Ligës së Konferencës mes dy skuadrave të fuqishme, Gent nga Belgjika dhe Zilina nga Sllovakia, e cila zhvillohet të enjten në orën 20:00. Kastrati, i njohur për integritetin dhe ndershmërinë e tij në fushën e lojës, do të ketë në asistencë Granit Hysenin dhe Lumturije Muhadrin, po ashtu dy emra të njohur dhe të respektuar në komunitetin e gjyqtarëve në Kosovë, teksa gjyqtar i katërt për këtë sfidë të rëndësishme është Ilir Mehmeti.



SHKURT

Norwichi dhe Galatasaray i japin tre milionë euro për Rashicën

Galatasaray ende nuk ka hequr dorë nga transferimi i Milot Rashicës. Ylli kosovar shkëlqeu në edicionin e tij të parë në futbollin turk dhe kjo ka bërë që klubit nga Stambolli t'i rriten apetitet për ta mbajtur ish-anëtarin e Vushtrisë, i cili ishte i huazuar nga Norwichi për një vit. Sipas medieve britanike, klubi nga Championshipi anglez i kërkon 10 milionë euro për Rashicën, kurse Galata është i gatshëm t'i ofrojë 7 milionë. Pra, kërkesën dhe ofertën për momentin i ndajnë 3 milionë euro. Rashica ka kontratë me Norwichin deri në verën e vitit 2025.

Frosinone shpreh interesim për Berishën

Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, u largua nga Torino. Mediet italiane raportojnë se ish-anëtari i Lazios dhe Atalantës karrierën mund ta vazhdojë në Serinë A, pasi Frosinone ka shprehur interesim për shërbimet e tij. E vetmja pengesë për kalimin e Berishës në klubin tjetër italian shihen të ardhurat, pasi Frosinone nuk besohet se është e gatshme ta paguajë rrogën e Berishës që besohet të jetë një milion euro neto.

Florian Marku pas një viti rikthehet në ring

Pas një mungese të gjatë prej rreth një viti, në ringun e boksit, 30-vjeçari lushnjar, Florian Marku, do të rikthehet në ring më 2 shtator, ku kësaj radhe kundërshtar i tij do të jetë boksieri irlandez Dylan Moran. Njoftimin për përballjen e radhës e ka bërë vetë Marku, i cili në botën e boksit njihet me nofken “Mbreti Shqiptar”. “Pas afërsisht një viti jashtë ndeshjeve erdhi koha për t'u rikthyer më fort se kurrë. Ndeshja do të zhvillohet në Mançester ‘Ao Arena’ më 2 shtator kundër irlandezit Dylan Moran. Mezi e kam pritur këtë ndeshje. Ju pres të gjithëve atje”, ka shkruar Marku.

City edhe në miqësore mposhti Bayernin

Manchester City ka arritur të marrë një tjetër fitore në miqësore, duke mundur me rezultat 1-2 Bayern Munchenin në Tokio. “Qytetarët” kanë treguar edhe një herë tjetër forcën e tyre, duke marrë një fitore kundër një rivali mjaft të fortë dhe që Cityt i shërben për të vazhduar me të njëjtin ritëm si sezonin e fundit. Goli i shënuar nga McAtee ka mjaftuar për pjesën e parë të ndeshjes, ndërkohë që në të dytën ishte Tell ai që barazoi për Bayernin në minutën e 81-të. Pak minuta më vonë Laporte ka gjetur golin e dytë për Cityn, duke i dhënë një fitore skuadrës së Guardiols.

Pilotët e Ferrarit: Këto janë vendet që meritojmë

MODENA, 26 KORRIK - Ferrari po kalon një tjetër krizë në botërorin e Formulës 1. Gara e fundit në Hungari, ku pilotët e "kokëkuqes" u klasifikuan në vendet 7-8, me Charles Leclerc e Carlos Sainz, tregojnë se makina italiane është për momentin forca e katërt në kampionat. Edhe pse pilotët

nuk dorëzohen për një renditje sa më të mirë, spanjoli i Ferrarit tregohet i ashpër me deklaratën e tij në prag të garës së Belgjikës. "Në Hungari u renditën në vendet 7-8 dhe, të jemi realiste, këto janë vendet që meritojmë të kemi me këtë paraqitje që po bëjmë. Red Bulli, McLareni e Mercedesi për

momentin janë më mirë se ne", ka thënë Sainz. "Edhe pse po e përmirësojmë makinën nga gara në garë, ka ende mjaft probleme dhe defekte që nuk arrijmë t'i zhvillojmë ashtu si duhet. Në fakt, presim të kemi një ritëm tjetër në garë, por s'po ndodh kështu. Ndoshta në Belgjikë duhet ta ndryshojmë


filozofinë tonë të garës", ka deklaruar Carlos Sainz. Edhe Frederic Vasseur, drejtor sportiv i Ferrarit, pranon gabimet: "Kemi bërë shumë të tilla. Ky është një rezultat që na penalizon. Kur shoh se sa shumë sekonda kemi humbur mes trafikut dhe në ndalesa, kuptojmë se gabimet janë



shumë. Në garë nuk arrijmë dot të jemi të shpejtë sa duhet".

Hoti rrëfen se si garuesi Besim Mulliqi humbi jetën para disa vjetësh pas kërcimit nga Ura e Mostarit

PRISHTINË, 24 KORRIK - Në Gjakovë të dielën u mbajt gara e kërcimeve nga Ura e Fshejtë, garë kjo tashmë tradicionale për këtë komunë që organizoi edicionin e 73-të të saj. Adrenalina e madhe është ajo me të cilën karakterizohet kjo garë, por edhe rreziku i pjesëmarrjes në të është mjaft i madh. Në mesin e tre anëtarëve të jurisë që vlerësonin garuesit, ishte edhe ish-garuesi dhe kërcimtari nga Ura e Fshejtë, Sokol Hoti, i cili ishte kampion i kësaj gare, por edhe nën-kampion i kërcimeve nga Ura e Mostarit në Bosnjë-Hercegovinë. Por, pikërisht nga ura e Mostarit, Hoti ka kujtime të hidhura pasi në vitin 1988 aty humbi jetën shoku i tij i ngushtë Besim Mulliqi pas kërcimit nga 30 metra lartësi. "Kam qenë kampion këtu nga Ura e Fshejtë dhe nga Ura e Mostarit nën-kampion. Në vitin 1987 kam kërcyer dhe në vitin 1988. Në '88-n kemi pasur një fatkeqësi, shoku im i ngushtë Besim Mulliqi, që u flijua për garë të Kosovës, sepse ishim vetëm tre shqiptarë, me kërcimin e tij fenomenal e theu



kurrikin nga Ura e Mostarit dhe pas një jave vdiq. Aty më ka mbetur trauma prej vitit 1988 sepse ka qenë kampion dhe kërcimtar i mirë dhe i shkëlqyeshëm", ka thënë Hoti. Ai tregon për "KosovaPress" se deri te ngjarja tragjike erdhi për shkak të lartësisë së madhe dhe shtypjes së lartë të ujit që i shkaktoi pëlcitjen e kurrit Besim Mulliqit. "Besimi 20-vjeçar ka qenë. Kjo ka mundur të më ndodhë edhe mua. Çdokujt mund t'i ndodhte sepse me të vërtetë është sport shumë i rrezikshëm, koncentrimi, por hyrja në ujë kur

është bërë, lartësia e madhe 30 metra nga Ura e Mostarit, këtu në qafë nga shtypja e ujit i ka pëlcit kurrikin. Menjëherë nuk ka mundur t'i lëvizë as këmbët e as duart. Por çfarë më ka mbetur në mendje, kur e kanë nxjerrë nga uji në Mostar, zhytësit nuk e kanë nxjerrë siç duhet, aty e kanë lënduar edhe më shumë. Shumë goditje e thellë, e dhimbshme për ne dhe familjen e tij", ka thënë Hoti. Ai shtoi se frika se diçka e tillë mund të ndodhë edhe në kërcimet nga Ura e Fshejtë i përcjellë nga vitit në vit kur nisin përgatitjet për organizimin e kësaj gare.

Browni rinovon kontratën me Bostonin, bëhet basketbollisti më i paguar në historinë e NBA-s

BOSTON, 26 KORRIK - Basketbollisti i Boston Celticsit, Jaylen Brown, është bërë lojtari më i paguar në historinë e NBA-s. 26-vjeçari rinovoi kontratën me skuadrën e Celticsit nga e cila do të përfitojë 304 milionë dollarë për pesë vitet e ardhshme. Pra, më shumë se 60 milionë në sezon. Një shifër që shkruan historinë e NBA-s edhe pse, sipas specialistëve, kjo gjë pritej, duke parë paraqitjet e Brownit që shkëlqeu në sezonin e fundit me Boston. Çuditërisht, ai nuk u përshi në ekipin e parë të sezonit të kaluar në NBA, por në pesëshen e dytë. Gjithsesi, kjo



nuk e ndali ta nënshkruajë kontratën e re, që kalon ndjeshëm atë të Nikola Jokiqit (276 milionë dollarë për pesë vjet me Denverin). Kjo kontratë pritej të zyrtarizohej kohë më parë, por lojtari ka qenë me pushime në

Spanjë dhe vetëm ditët e fundit është rikthyer në Boston, ku dhe ka hedhur firmën në kontratën e re, pasi kreu vizitat mjekësore. Lajmin e konfirmoi Jasin Glushon, agjenti i basketbollistit. Skuadra e Bostonit ka luajtur në tri finale të Konferencës së Lindjes në katër vitet e fundit dhe Jaylen Brown ka qenë një nga lojtarët më të mirë. Ai formon një dyshe të jashtëzakonshme me Tatum, që verën e ardhshme edhe ai mund të nënshkruajë një kontratë të re, për të thyer këtë rekord të shokut të skuadrës.

SHKURT

Messi po shkëlqen tek Inter Miami

Lionel Messi e ka nisur në mënyrë të jashtëzakonshme përvojën e re amerikane. Ylli argjentinas ishte protagonist edhe në ndeshjen e tij të dytë me Inter Miami CF 36-vjeçari dhuroi spektakël dhe i realizoi dy gola në fitoren 4:0 ndaj Atlanta United FC, në ndeshjen e vlefshme për Kupën e Ligës, por atij nuk i mungoi as asistimi. Messi me këtë rast arriti në kuotën e tri golave në dy ndeshje në futbollin amerikan. Shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" kishte realizuar gol spektakolar nga gjuajtja e lirë në fitoren ndaj Cruz Azul në debutimin e tij në futbollin amerikan.

Interi konfirmon Lautaron si kapiten të ri

Interi ka konfirmuar zyrtarisht sulmuesin Lautaro Martinez si kapiten të ri të klubit për sezonin 2023/24. Largimi i Samir Handanoviçit dhe Marcelo Brozoviçit këtë verë i la "Nerazzurrët" pa kapiten dhe sulmuesi argjentinas ka qenë zgjedhja e dukshme për ta marrë shiritin në krah, pasi e kishte veshur atë në disa raste sezonin e kaluar. Lautaro është rritur në një figurë lideri për Interin që nga ardhja e tij në vitin 2018 dhe thuhet se refuzoi një ofertë fitimprurëse nga Arabia Saudite kohët e fundit në një shfaqje besnikërie ndaj klubit milanez. Siç u njoftua, Lautaro tani është kapiteni i ri i klubit të Interit, me Nicolo Barella që u promovua në zëvendëskapiten. Lisa Alborghetti është kapitene e skuadrës së Interit për Femra. Njoftimi i "Nerazzurrëve" iu referua materialit të marketingut të filmit të ri të Barbies. Lautaro ka bërë 238 paraqitje në të gjitha garat për Interin që nga ardhja e tij më 2018, duke shënuar 102 gola dhe duke dhënë 36 asistime në atë kohë.

City nuk e lejon Silvën të largohet

Bernardo Silvës nuk do të largohet nga Manchester City. "90min" raporton se skuadra e Pep Guardiols nuk është e gatshme ta lejojë largimin e portugezit. Interesim për yllin portugez ka shfaqur PSG-ja, Barcelona dhe Al-Hilali, por fituesi i tripletës, Manchester City, nuk e ka ndërmend të heqë dorë nga ylli i saj. 28-vjeçari është pjesë e klubit anglez që nga viti 2017, derisa ka luajtur në të kaluarën për Monaco dhe Benficën.

Hendersoni largohet nga Liverpooi, shkon tek Al Ettifaqi

Jordan Hendersoni tashmë mund të quhet edhe pse jo në një formë zyrtare, si lojtari më i ri i Al Ettifaqit, klub në Arabinë Saudite. Ai ndodhet në kampin e klubit për ta përfunduar firmën e kontratës së tij të re, ku do të lidhet me skuadrën saudite për tri vjet. Epoka e tij 12-vjeçare ka përfunduar te Liverpooi, ku me klubin anglez ka luajtur 492 ndeshje, ka shënuar 39 gola, ka asistuar 74 herë dhe ka fituar tetë trofe.

Inzaghi: Titulli është objektivi ynë i madh

Interi po përgatitet për sezonin e ri. Zikaltrit kërkojnë të rikthehen te titulli kampion, ndërsa do të synohet edhe një paraqitje sa më dinjitoze në Ligën e Kampionëve. "Sezoni i

kaluar ishte i mirë, kemi fituar Kupën e Italisë, Superkupën dhe luajtëm në finalen e Ligës së Kampionëve, që mbetet gjithmonë një rezultat shumë i madh. Jemi rritur shumë në

nivel evropian në krahasim me vitin e parë. Nuk të ndodhë çdo vit që të arrish në finale. Interi nuk i ndodhte prej 12 vjetësh, ndaj është një motiv krenarie", ka thënë

trajneri i nënkampionëve të Evropës, Simone Inzaghi. "Këtë vit duam të rikonfirmohemi në Evropë, do ta provojmë përsëri, edhe pse e dimë se do të jetë shumë e

vështirë. Titulli është objektivi ynë i madh. Po përforcohem dhe po përgatitemi të luftojmë. Kemi shpresa ta fitojmë titullin kampion", ka shtuar Inzaghi.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Administrator/e i/e Rrjetit (zyrtar i ri)
Departamenti:	Teknologjia Informative
Divizioni:	Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
Grada:	7
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve

Administratori i Rrjetit është përgjegjës për administrimin, përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës së rrjetave të teknologjisë informative. Gjithashtu është përgjegjës për sigurinë e informacionit në infrastrukturën e rrjetit.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Instalon, konfiguron, administron dhe mirëmban të gjitha komponentët e rrjetave (Router, Firewall, Switch, VOIP dhe pajisje tjera të rrjetës) që janë pjesë e infrastrukturës së TI-së në BQK;
- Konfiguron dhe mirëmban ndërlihdjet (VPN) me institucionet tjera;
- Analizon kërkesat për ndryshim ose shtim të funksioneve në rrjetin e BQK-së dhe ofron zgjidhje adekuate;
- Bashkëpunon ngusht me administratorët dhe teknikët brenda divizionit dhe me zyrtarët e Divizionit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Punës;
- Trajton gjetjet nga monitorimet dhe raportet e sigurisë së informacionit;
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative;
- Zgjidh problemet që raportohen nga shfrytëzuesit e brendshëm dhe të jashtëm të rrjetit të BQK;
- Monitoron dhe bën matje të performancës së komponentëve të rrjetave, duke përfshirë pajisjet e BQK-së në shfrytëzim nga shfrytëzuesit e jashtëm;
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtëm;
- Planifikon dhe ofron zgjidhje bazuar në matjet e komponentëve për të siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë e shërbimeve të rrjetit;
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës;
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI;
- Aplikon udhëzimet dhe standardet e sigurisë;
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkallë bachelor në shkenca kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit të rrjetit, CCNA, PCNSA, JNCIA.
- Përvojë e preferuar, se paku 1 vjeçare në administrim të rrjetave. Përvoja në sigurinë e rrjetave është e preferuar.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Certifikata e Vendbanimit.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 gusht 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija:	Administrator mreže (niži službenik)
Odeljenje:	Informaciona tehnologija
Divizija:	Informacione tehnologije i sistemi
Stepen:	7
Izveštava:	Rukovodiocu Divizije za informacione tehnologije i sistema

Administrator mreže je odgovoran za administraciju, poboljšanje i unapređenje mrežne infrastrukture informacione tehnologije. Takođe je odgovoran za bezbednost informacija u infrastrukturi mreže.

Radne dužnosti i odgovornosti:

- Instalira, konfiguriše, administrira i održava sve mrežne komponente (Router, Firewall, Switch, VOIP i druge mrežne uređaje) koje su deo IT infrastrukture u CBK;
- Konfiguriše i održava interkonekcije (VPN) sa drugim institucijama;
- Analizira zahteve za promenu ili dodavanje funkcija u mreži CBK-a i nudi adekvatna rešenja;
- Blisko saraduje sa administratorima i tehničarima u okviru odeljenja i sa službenicima Divizije za bezbednost informacija i kontinuitet poslovanja;
- Bavi se nalazima od praćenja i izveštaja bezbednosti informacija;
- Služi kao drugi nivo rešavanja incidenata i problema za sve korisnike informacione tehnologije;
- Rešava probleme prijavljene od strane internih i eksternih korisnika mreže CBK-a;
- Prati i meri performansu mrežnih komponenti, uključujući opremu CBK-a koju koriste spoljni korisnici;
- Održava licence i komunicira sa spoljnim provajderima usluga;
- Planira i pruža rešenja zasnovana na merenjima komponenti kako bi se obezbedio kontinuitet i bezbednost mrežnih usluga;
- Održava konfiguracionu dokumentaciju, kreira procedure i priručnike za svu opremu i usluge za koje je odgovoran;
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranjima;
- Primenjuje smernice i standarde bezbednosti;
- Druge poslove koje po hijerarhiji Odeljenja za informacionu tehnologiju poveri odgovorni.

Kvalifikacije i iskustvo:

- Nivo bačelor iz računarskih nauka ili relevantne sertifikate vezane za ulogu Administratora mreže, CCNA, PCNSA, JNCIA.
- Poželjno najmanje 1 godina iskustva u administraciji mreža. Poželjno je iskustvo u bezbednosti mreža.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Engleski jezik - poželjno.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Sertifikat o prebivalištu.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **10. avgust 2023**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Administrator/e i/e bazave të të dhënave (zyrtar i ri)
Departamenti:	Teknologjia Informative
Divizioni:	Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
Grada:	7

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Administron bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen në Departamentin e Teknologjisë Informative;
- Planifikon krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave. Punon ngushtë me administratorët e sistemeve gjatë instalimit të aplikacioneve të cilat lidhen me bazat e të dhënave;
- Instalon versione të reja të databazave dhe veglave të saj, si dhe veglave të tjera të nevojshme për qasje në baza të të dhënave;
- Vlerëson versionet e databazave, veglave ndihmëse, në mënyrë që të sigurojë se baza e të dhënave punon sipas standardeve. Në bashkëpunim me administratorët e tjerë dhe zhvilluesit e aplikacioneve, planifikon përditësime me ndikim minimal në punën e sistemeve;
- Administruesi i bazave të të dhënave është edhe pikë kontakti me Oracle dhe Microsoft Support, si dhe kompanitë e tjera që kanë aplikacione dhe baza të të dhënave në BQK;
- Shkruan procedura (Ang. "stored procedures") të cilat përdoren për nxjerrjen e raporteve nga bazat e të dhënave në Oracle;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të databazave;
- Rregullon problemet e ndryshme në bazat e të dhënave, aplikacioneve, komunikimin në mes tyre dhe veglave të tjera të cilat raportohen nga shfrytëzuesit;
- Monitoron dhe në rast të problemeve, rregullon problemet me komunikim në mes të databazave dhe aplikacioneve të ndryshme;
- Konfiguron bazat e të dhënave për "high availability";
- Planifikon, implementon dhe teston në mënyrë të vazhdueshme procedurat për backup dhe restore të bazave të të dhënave;
- Kryen proceset e EOD (End of Day) pas mbylljes së orarit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqës-i/ja.

Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri në administrimin e bazave të të dhënave të bazuara në Oracle ose MS SQL;
- Njohuri në dizajnimin logjik dhe fizik të bazave të të dhënave;
- Aftësi të kryejë rregullime në performancën e bazave të të dhënave;
- Të jetë i aftë të ofrojë strategji gjatë zhvillimit të bazave të të dhënave;
- Shkathtësi në shkrimin e query të ndryshëm sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të të drejtave të shfrytëzuesve të bazave të të dhënave;
- Përvojë në migrime të bazave të të dhënave;
- Njohuri në performance tuning të bazave të të dhënave;
- Përvojë në T-SQL ose PL/SQL.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Shkallë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose certifikime profesionale për Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP), MS SQL Database Administration;
- Përvojë pune e preferuar, së paku 1 vjeçare në administrimin e bazave në Oracle ose MS SQL;
- Gjuha angleze - e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
